

Pozita	Udhëheqës/e i/e Programit	
Periudha e punësimit (Prej – Deri)	Dhjetor 2023	31 korrik 2026
Lokacioni	Prishtinë	
Kjo pozitë i raporton:	Drejtorit të Departamentit për Hulumtim dhe Avokim	

Për KCSF

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), është organizatë udhëheqëse në përkrahjen e nismave qytetare në Kosovë që nga viti 1998. KCSF ofron fonde për shoqërinë civile nëpërmjet mekanizmave e sistemeve të avancuara të dhënies së granteve, ndërton kapacitete e dije për sektorin nëpërmjet Qendrës së KCSF-së, si dhe mbron dhe shtyn përpara hapësirën për qytetari dhe ambientin e veprimit të shoqërisë civile në Kosovë dhe më gjerë, nëpërmjet hulumtimit të politikave, avokimit dhe mobilizimit të sektorit. KCSF beson që një shoqëri civile e fuqishme me përfshirje të vërtetë të qytetarëve në punën e vet është element kyç për një qeverisje përfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse, e që kontribuon në shndërrimin e Kosovës në një shoqëri demokratike me perspektivë të integritetit evropian dhe me një situatë të avancuar socio-ekonomike.

Programi për Angazhim Qytetar - Citizen Engagement Activity (CEA)

Programi për Angazhim Qytetar - Citizen Engagement Activity (CEA) është një program pesë vjeçar i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) i cili financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Programi do të përkrahë aktivitete të shumta të cilat synojnë përmirësimin e lidhjes së shoqërisë civile me qytetarë, bashkëpunimin brenda sektorit dhe me sektorë të tjerë, si dhe diversifikimin e burimeve të shoqërisë civile përtej fondeve të donatorëve të huaj me qëllim të fuqizimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies të institucioneve publike dhe të OShC-ve ndaj publikut.

Bazuar në përvojën e gjatë dhe ekspertizën e KCSF-së në zhvillimin e shoqërisë civile, duke përfshirë qasje të reja që kanë për qëllim ndërlidhjen e organizatave të shoqërisë civile me qytetarë dhe qytetare të Kosovës, dhe në bashkëpunim me organizata vendore dhe ndërkombëtare, CEA do të kontribuojë drejt arritjes së objektivave në vijim:

Objektiva 1 – Fuqizimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile me qytetarë dhe qytetare të Kosovës, nxitja e aktivizimit komunitar dhe rritja e kërkesës për llogaridhënie.

Objektiva 2: Krijimi i partneriteteve brenda dhe ndërmjet sektorëve dhe rritja e besimit mes OShC-ve, qytetarëve, sektorit privat dhe institucioneve publike.

Objektiva 3: OShC me njohuri e aftësi të shtuara që e shfrytëzojnë kuadrin e përmirësuar ligjor dhe zhvillojnë kulturën e përkrahjes së aktiviteteve jo-për-përfitim nga burimet vendore dhe të diasporës

Për pozitën

Udhëheqësi/ja i/e Programit ka përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e përgjithshëm të Programit për Angazhim Qytetar (CEA). Kjo pozitë kërkon qasje proaktive ndaj planifikimit cilësor dhe në kohë të punës, për të siguruar zbatim cilësor të aktiviteteve të Programit. Ndër të tjera, detyrat kryesore të kësaj pozite përfshijnë edhe menaxhimin e stafit të programit, mbikëqyrjen e zbatimit cilësor të sistemit të Monitorimit, Vlerësimit dhe Mësimit (M&E&L), përfaqësimin e organizatës brenda dhe jashtë vendit, raportimin në kohë dhe komunikim me USAID-in.

Udhëheqësi/ja i/e Programit ka në menaxhim të drejtëpërdrejtë Zëvendës Udhëheqësen e Programit, Menaxheren e Financave, Specialistin për Komunikim, dhe Specilisten/in për Vlerësim dhe Monitorim.

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Udhëheq zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të të gjitha aktiviteteve që lidhen me Programin për Angazhim Qytetar (CEA), në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e Departamentit;
- Udhëheq stafin e Programit, duke siguruar komunikimin dhe kordinimin mes të gjithëve/gjithave për arritjen efektive të objektivave të programit.
- Siguron që të gjitha aktivitetet e Programit të kryhen brenda buxheteve të përcaktuara dhe çdo nevojë për rishikim të buxhetit të adresohet në mënyrë adekuate;
- Siguron që të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me Programin të realizohen në kohë dhe sipas standardeve të përcaktuara të KCSF-së, dhe të gjitha sfidat të adresohen në përputhje me rrethanat dhe në mënyrë adekuate;
- Siguron përgatitjen cilësore dhe në kohë të planeve të punës, raporteve tremujore të performancës së programit, raporteve vjetore, raporteve financiare dhe çdo raport tjetër të kërkuar nga donatori, Drejtori i Departamentit ose Drejtori Ekzekutiv;

- Siguron një vizion të integruar ndërmjet komponentëve dhe partnerëve të Programit, me fokus në arritjen e rezultateve të përcaktuara në kontratë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e Departamentit;
- Siguron që parimet e menaxhimit të adaptueshëm të zbatohen gjatë gjithë Programit, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e Departamentit, Zëvendës Udhëheqësen e Programit, dhe Menaxheren e Financave;
- Siguron që të gjithë partnerët, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe ofruesit e shërbimeve të lidhura me Programin të kontraktohen dhe menaxhohen sipas rregullores së punës dhe rregulloreve tjera të KCSF-së;
- Siguron raportim në kohë dhe komunikim efektiv me donatorin;
- Siguron bashkëpunim efektiv me programet e tjera përkatëse dhe palët e interesuara duke përfshirë USAID-in, partnerët zbatues të USAID, qeverinë dhe palët e tjera të interesuara.

Kualifikimet

- Së paku 10 vite përvojë pune në programe në fushën e qeverisjes, me preferencë në organizata të shoqërisë civile;
- Së paku pesë vite përvojë menaxheriale, me preferencë në programe dhe/ose organizata të financuara nga USAID;
- Përvojë e dëshmuar e punës me partnerë dhe/ose hisedarë;
- Përvojë në menaxhim dhe mirëmbajtje të raporteve me donatorë;
- Përvojë pune me organizata të shoqërisë civile dhe nisma qytetare;
- Aftësi për ndërtim dhe komunikim të argumenteve dhe pozicioneve komplekse, të ndërlidhura me Programin;
- Njohuri të parimeve dhe praktikës së funksionimit të politikë-bërjes në Kosovë, dhe përvojë bashkëpunimi me institucione publike;
- Njohuri të sistemeve për Monitorim dhe Vlerësim;
- Diplomë e studimeve bazike (Bachelor) në Administratë Publike, Shkenca Politike apo fusha tjera të ndërlidhura në kuadër të shkencave shoqërore. Diploma e studimeve Master dhe/ose studimet e ndërlidhura me organizata të shoqërisë civile do të konsiderohen përparësi;
- Aftësi të shkëlqyeshme të shkrimit në gjuhën shqipe dhe angleze, ndërsa aftësitë e njejta në gjuhën serbe do të konsiderohen përparësi.

Si të aplikohet

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- CV, me tre kontakte si referenca
- Letër motivimi

Dokumentet e lartshënuara duhet të dërgohen në e-mail adresën aplikimi@kcsfoundation.org deri më **22 nëntor 2023**. Dokumentet e aplikimit mund të jenë në gjuhën shqipe, serbe, ose angleze. Në fazën e parë të aplikimit, nuk kërkohet dërgimi i asnjë informate apo dokumenti shtesë.

Siguria e të dhënave dhe parimet e privatësisë janë të rëndësishme për ne. Të dhënat tuaja do t'i trajtojmë me konfidencialitet të plotë.

KCSF synon që të angazhojë një Udhëheqës/e të Programit, me orar të plotë, duke filluar prej muajit dhjetor 2023. Ambienti dhe kushtet e punës janë të shkëlqyeshme ndërsa pagesa vendoset varësisht nga kandidati(ja) e përzgjedhur.

Vetëm kandidatët(et) e përzgjedhur(a) në listën e ngushtë do të kontaktohen. Varësisht nga cilësia e aplikacioneve dhe numri i kandidatëve(eve) të përzgjedhur(a) në listën e ngushtë, KCSF mund të kërkojë nga kandidatët(et) e listës së ngushtë t'i nënshtrohen testeve dhe/ose intervistave shtesë.

Në mungesë të aplikacioneve të përshtatshme, KCSF mban të drejtën që të mos përzgjedhë asnjë nga kandidatët(et) e paraqitur(a).

KCSF është organizatë e cila e vlerëson diversitetin brenda stafit, përkushtohet për mos-diskriminim dhe siguron trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve e kandidateve gjatë procedurës së rekrutimit, pa paragjykime, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, mosha, përkatësia kombëtare, orientimi seksual, gjendja martesore, vendbanimi, nevojat e veçanta apo ngjyra.